

## 23-29 Prill 2018

# Java Europiane e Vaksinimit

### *TË MBROJTUR SË BASHKU*

#### **Vaksinimi nuk është vetëm një e drejtë personale por edhe një përgjegjësi e përbashkët**

Java Europiane e Vaksinimit ofron mundësinë që, në prill të çdo viti në vende të ndryshme, të promovohet rëndësia dhe përfitimet që shëndeti publik ka nga vaksinat. Që në fillimet e saj në vitin 2005, Java Europiane e Vaksinimit ka arritur të bëhet një ngjarje e rëndësishme me shtrirje të gjerë në rajon, duke përfshirë qindra iniciativa që rrisin ndërgjegjësimin mbi këtë çështje.

Zbatimi i gjerë i programeve të vaksinimit gjatë 30 viteve të fundit ka çuar në një rënie drastike të sëmundshërisë dhe vdekshmërisë, të shkaktuara nga sëmundjet që parandalohen nga vaksinat.

Rajoni European vazhdon të ketë një mbulesë vaksinale të lartë gjatë fëmijërisë. Megjithatë, një numër jo i vogël fëmijësh nuk marrin mbrojtje vaksinale të nevojshme, duke shërbyer kështu si transmetues të infeksioneve të personat e tjerë.

#### **Fakte:**

- Vaksinimi mbron nga sëmundje të tilla si: hepatiti, fruthi, difteria, pneumonia, shytat, poliomieliti, kolla e mirë, rubeola, tetanozi, diarreja nga rotavirusi, kanceri i qafës së mitrës etj., sëmundje të cilat nëse nuk parandalohen nga vaksinat mund të shkaktojnë paaftësi dhe të çojnë deri në vdekje.
- Në vitin 2016, 1 në 15 fëmijë në rajon nuk u vaksinua me dozën e parë të vaksinës së fruthit dhe 1 në 21 fëmijë nuk morën asnjë dozë të vaksinës së Difteri-Tetanoz-Pertus. Këto hendeqe të krijuara kanë çuar në shpërthime të fruthit që mund të shmangeshin nga vaksinimi.
- Mbulesa vaksinale botërore ka arritur në 86%, pa pësuar ndryshime domethënëse gjatë viteve të fundit.
- Vaksinimi mund të evitojë përafërsisht 2-3 milionë vdekje çdo vit. Nëse mbulesa vaksinale do të përmirësohej, atëherë do të parandaloheshin edhe 1,5 milionë vdekje të tjera.
- Megjithatë, 19.5 milionë fëmijë në mbarë botën nuk po marrin vaksinimin e duhur.

#### **Fokusi i fushatës për vitin 2018**

Të gjithë mund të ndihmojnë për të pakësuar boshllëqet e krijuara në imunizim. Tema e fushatës së Javës Europiane të Vaksinimit është “Vaksinimi nuk është vetëm një e drejtë personale por edhe një përgjegjësi e përbashkët”. Prandaj nën sloganin *TË MBROJTUR SË BASHKU*, bëhet thirrje për vaksinim të çdo individi, pa lënë askënd pas.

#### **Vaksinat të mbrojnë ty dhe këdo përreth teje**

Vaksinat sigurojnë mbrojtje individuale nga shumë sëmundje të rrezikshme, por përfitimi prej tyre nuk mbaron aty. Kur i gjithë komuniteti është i vaksinuar, nuk mbetet asnjë person që mund

të trasetojë sëmundje ngjitëse te personat më të rrezikuar për të shfaqur ndërlikime serioze. Pra, duke u vaksinuar të gjithë së bashku, ne mund të mbrojmë personat më vulnerabël (të prekshëm), përfshirë foshnjat. Çdo person meriton të imunizohet dhe duhet të ndajë përgjegjësinë sociale për të mbrojtur ata që nuk mund të mbrojnë veten.

Duke u vaksinuar ne jemi ***TË MBROJTUR SË BASHKU***